



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimit
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Modelim

Niveli III në KSHK¹, referuar niveli III të KEK²

D3-III-19

Tiranë më, Mars 2019

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Modelim			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar niveli III të KEK	D3-III-19
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Modelim”, niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK, është të përgatisë modelistë të kualifikuar për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me prodhimin dhe konfeksionimin e veshjeve, si dhe të zhvillojë individin, jo vetëm nga ana profesionale, por edhe personalitetin e tyre në mënyrë që të jetojnë në përshtatje me mjedisin që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në shkollat që ofrojnë kualifikim profesional në “Modelim” niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë përfunduar kualifikimin profesional “Tekstil-Konfeksion”, niveli II në KSHK, referuar niveli II të KEK,; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. - kanë aftësi të kufizuara, për të cilët institucioni arsimor krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Modelim”, niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës të këtij niveli, si punonjës i kualifikuar në këtë fushë, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës në ndërmarrje të ndryshme të prodhimit të veshjeve, në punishte të ndryshme artizanale dhe atelie mode apo të vetëpunësohet.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimit në nivelin IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, (menaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimit	(kur të miratohet)			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	D-II-03-14			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Në përfundim të kualifikimit profesional “Modelim” niveli II, individi do të përforcojë njohuritë profesionale të fituar në Nivelin I, si dhe do të zotërojë njohuritë profesionale të si më poshtë:

Organizimi i punës dhe komunikimi

- Të përshkruajë legjislacionin e punës, organizimin dhe funksionimin e një biznesi;
- Të përshkruajë mënyrën e realizimit të një plan biznesi;
- Të listojë metodat e komunikimit dhe rëndësinë e një komunikimi profesional;
- Të përshkruajë rëndësinë e të dëgjuarit dhe të kuptuarit në një komunikim;
- Të përshkruajë rëndësinë e shprehjes saktë dhe në mënyrë profesionale;
- Të përshkruajë rëndësinë e një komunikimi profesional me klientët, furnitorët dhe bashkëpunëtorët;
- Të përshkruajë mënyrat e informimit profesional të klientëve sipas kërkesave të tyre;
- Të përshkruajë rëndësinë e plotësimit të kërkesave të porosisë së klientit;
- Të përshkruajë rëndësinë e plotësimit të porosisë së klientit, brenda afatit të përcaktuar;
- Të përshkruajë rëndësinë e marrëdhënieve korrekte me furnitorët dhe bashkëpunëtorët;
- Të përshkruajë rregullat e plotësimit të dokumenteve të fletëhyrjeve dhe fletëdaljeve, të mallit dhe të porosisë;
- Të shpjegojë rëndësinë e vendosjes së prioriteteve në punën e përditshme;
- Të shpjegojë rëndësinë e organizimit dhe zbatimit të radhës së punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e punës në ekip/grup dhe parimet kryesore;
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes të kostos;
- Të shpjegojë mënyrën e llogaritjes kohës së punës;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes bazës materiale;

Sigurimi teknik

- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të materialeve të punës;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë zhvendosjeve në vendin e punës;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të makinave të ndryshme të qepjes;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të pajisjeve dhe mjeteve të punës;
- Të përshkruajë rregullat e higjienës gjatë punës;
- Të përshkruajë rregullat e ruajtjes së mjedisit;

- Të përshkruajë mbledhjen, klasifikimin dhe paketimin e mbetjeve dhe kryesisht atyre të rrezikshme;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrat e ndryshme të riciklimit të mbetjeve teknologjike.

Moda dhe estetika

- Të përshkruajë rëndësinë e estetikës në veshje;
- Të përshkruajë kodin e veshjeve;
- Të shpjegojë karakteristikat estetike të veshjes për grupmosha të caktuara;
- Të rendisë funksionin estetik dhe praktik të veshjeve;
- Të përshkruajë estetikën e veshjeve popullore;
- Të shpjegojë ndikimin e modës dhe estetikës në procesin e modelimit;
- Të përshkruajë individualitetet, risitë dhe tendencat në modë në lidhje me modelimin;
- Të përshkruajë zhvillimin historik të prerjes dhe modelimit të veshjes në periudha të ndryshme historike;
- Të përshkruajë zhvillimin bashkëkohor të prerjes dhe modelimit të veshjeve;
- Të përshkruajë linjat kryesore të fustaneve, “A”, “H”, “T”, “I”, “V”, “X”, “Y”, linja trapez, linja trekëndësh, linja këmbanë, linja amforë, linja tullumbace, linja princeshë, linja asimetrike, linja sirenë;
- Të shpjegojë rëndësinë e ngjyrave në fushën e modës;
- Të listojë ngjyrat e para, të dyta, të treta, ngjyrat e ngrohta dhe të ftohta;
- Të përshkruajë përshtatjen e ngjyrave në veshje sipas stinës.

Materialet tekstile

- Të shpjegojë llojet e fibrave tekstile (natyrale dhe artificiale);
- Të përshkruajë karakteristikat e fibrave të ndryshme tekstile;
- Të tregojë me anë të shikimit apo prekjes fibrat që përbëjnë pëlhurën;
- Të identifikojë me anë të djegies fijet që përbëjnë pëlhurën;
- Të përshkruajë përpunimin industrial të fibrave tekstile;
- Të interpretojë sistemin e matjes dhe treguesit e tyre;
- Të identifikojë me anë të mikroskopit dhe analizës kimike fijet që përbëjnë pëlhurën;
- Të dallojë llojet e pëlhurave;
- Të dallojë llojet e thurjeve në pëlhurë;
- Të përshkruajë llojet e ngjyruesve;
- Të përshkruajë mënyrat e ngjyritit të pëlhurave;
- Të dallojë llojet e trikotazheve;
- Të interpretojë koeficientin e elasticitetit të pëlhurave dhe trikotazheve.

Vizatimi i modeleve të veshjeve

- Të përshkruajë proporcionet e trupit të njeriut;
- Të përshkruajë lëvizjet kryesore të trupit të njeriut;
- Të përshkruajë zhvillimin e trupit të njeriut dhe pikat antropometrike për matjen e tij;
- Të përshkruajë skicën teknike të detajeve të veshjes (jakat, xhepi, palat, vrimat, kopsat, zinxhiri, tegelat etj.);
- Të shpjegojë skicën teknike të modeleve të ndryshme;

- Të përshkruajë modelin e veshjes nga figurina në skicë teknike;
- Të analizojë ndikimin e materialit në veshje të ndryshme;
- Të përshkruajë si zërthehen pjesët përbërëse të një modeli;
- Të përshkruajë rëndësinë e vizatimit skematik të veshjes si përpara ashtu edhe mbrapa.

Parapërgatitja për fillimin e punës

- Të përshkruajë mënyrën e marrjes së masave të duhura për elementë të ndryshëm të veshjes;
- Të rendisë mjetet e punës që nevojiten për ndërtimin e kallëpit të prerjes;
- Të listojë etapat e punës që nga skica teknike, zërthimi dhe realizimi i kartëmodelit, vendosja mbi tekstil e deri te procesi i qepjes;
- Të analizojë rëndësinë e etapave të punës së modelistit për cilësinë e produktit përfundimtar;
- Të identifikojë makinat qepëse që duhen për realizimin e kampionit të veshjes.

MODELIMI DHE PRERJA

Modelimi i fundeve

- Të shpjegojë rëndësinë e spostimit të pencave në modelin e fundeve të ndryshme;
- Të përshkruajë modele të ndryshme të fundeve (fundi i drejtë, i ngushtë, me baskinë, me kinda, me pala, verëf, etj.)
- Të përshkruajë kallëpin e prerjes së modeleve të ndryshme të fundeve;
- Të shpjegojë zërthimin e skicës teknike në kallëpin e prerjes;
- Të përshkruajë lloje të ndryshme të xhepave që përdoren në funde të modeluara.
- Të shpjegojë përshtatjen e materialit të pëlhurës me modelin e fundit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të marzheve të qepjes dhe cikatjeve në kartëmodelet e ndryshme të fundeve;
- Të përshkruajë mënyrën e duhur të vendosjes së kallëpit në tekstil;
- Të shpjegojë defektet e mundshme trupore dhe ndërhyrjen në kallëpin e prerjes për përmirësimin e tyre;

Modelimi i pantallonave (femra meshkuj)

- Të përshkruajë modele të ndryshme të pantallonave (femra dhe meshkuj);
- Të përshkruajë kallëpin e prerjes së modeleve të ndryshme të pantallonave;
- Të shpjegojë zërthimin e skicës teknike në kallëpin e prerjes;
- Të përshkruajë lloje të ndryshme të xhepave që përdoren në pantallona të ndryshme, për femra dhe meshkuj;
- Të shpjegojë përshtatjen e materialit të pëlhurës me modelin e pantallonave;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të marzheve të qepjes dhe cikatjeve në kartëmodelet e ndryshme të pantallonave;
- Të përshkruajë mënyrën e duhur të vendosjes së kallëpit në tekstil;
- Të shpjegojë defektet e mundshme trupore dhe ndërhyrjen në kallëpin e prerjes për përmirësimin e tyre;

Modelimi i këmishëve (femra meshkuj)

- Të shpjegojë rëndësinë e spostimit të pencave në modelin e këmishëve të ndryshme;

- Të përshkruajë modele të ndryshme të këmishëve (femra dhe meshkuj)
- Të përshkruajë kallëpin e prerjes së modeleve të ndryshme të këmishëve;
- Të shpjegojë zbrëthimin e skicës teknike në kallëpin e prerjes;
- Të përshkruajë lloje të ndryshme të jakave, xhepave, mëngëve dhe manshetave që përdoren në këmisha të modeluara;
- Të shpjegojë përshtatjen e materialit të pëlhurës me modelin e këmishës;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të marzheve të qepjes dhe cikatjeve në kartëmodelet e ndryshme të këmishëve;
- Të përshkruajë mënyrën e duhur të vendosjes së kallëpit në tekstil;
- Të shpjegojë defektet e mundshme trupore dhe ndërhyrjen në kallëpin e prerjes për përmirësimin e tyre;

Modelimi i fustaneve

- Të shpjegojë rëndësinë e spostimit të pencave në modelin e fustaneve të ndryshme;
- Të përshkruajë modele të ndryshme të fustaneve (me penca, pa penca, dopio pet, lloje të ndryshme kindash, prerje poshtë gjoksit, për gra shtatzëna, sirena, asimetrike, me palëzime, fustan me mëngë të ndryshme, etj.);
- Të përshkruajë kallëpin e prerjes së modeleve të ndryshme të fustaneve;
- Të shpjegojë zbrëthimin e skicës teknike në kallëpin e prerjes;
- Të përshkruajë lloje të ndryshme të jakave dhe mëngëve që përdoren në fustane të modeluara;
- Të shpjegojë përshtatjen e materialit të pëlhurës me modelin e fustanit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të marzheve të qepjes dhe cikatjeve në kartëmodelet e ndryshme të fustaneve;
- Të përshkruajë mënyrën e duhur të vendosjes së kallëpit në tekstil;
- Të shpjegojë defektet e mundshme trupore dhe ndërhyrjen në kallëpin e prerjes për përmirësimin e tyre;
- Të shpjegojë kallëpin e prerjes së modeleve të fustaneve për nuse dhe ceremoniale.

Modelimi i xhaketave dhe palltove (femra dhe meshkuj)

- Të shpjegojë rëndësinë e spostimit të pencave në modelin e xhaketave dhe palltove të ndryshme për femra dhe meshkuj;
- Të përshkruajë modele të ndryshme të xhaketave dhe palltove (për femra dhe meshkuj);
- Të përshkruajë kallëpin e prerjes së modeleve të ndryshme të xhaketave dhe palltove;
- Të shpjegojë zbrëthimin e skicës teknike në kallëpin e prerjes;
- Të përshkruajë lloje të ndryshme të jakave dhe xhepave që përdoren në xhaketa dhe pallto të modeluara;
- Të shpjegojë përshtatjen e materialit të pëlhurës me modelin e xhaketës dhe palltos;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të marzheve të qepjes dhe cikatjeve në kartëmodelet e ndryshme të xhaketave dhe palltove;
- Të shpjegojë kallëpin e prerjes së modeleve të pardesyve dhe pelerinave për burra dhe femra;
- Të përshkruajë mënyrën e duhur të vendosjes së kallëpit në tekstil;
- Të shpjegojë defektet e mundshme trupore dhe ndërhyrjen në kallëpin e prerjes për përmirësimin e tyre;

Modelimi i veshjeve për fëmijë

- Të përshkruajë rëndësinë e përzgjedhjes së materialit të përshtatshëm në veshjet për fëmijë;
- Të përshkruajë prerjen e modeleve të veshjeve të ndryshme për fëmijë;
- Të shpjegojë kallëpin e prerjes së modeleve të veshjeve për fëmijë;

Të brendshmet

- Të përshkruajë rëndësinë e përzgjedhjes së materialit të përshtatshëm në veshjet e brendshme;
- Të shpjegojë kallëpin e prerjes së modeleve të ndryshme të kominosheve dhe tutave;
- Të shpjegojë kallëpin e prerjes së të linjtave (të brendshmeve) dhe rrobave të banjës;

Zhvillimi i numrave

- Të identifikojë pikat e lëvizshme dhe të palëvizshme gjatë zhvillimit të numrave;
- Të analizojë grafikisht zhvillimin e numrave në skemën e prerjes;

Përdorimi i kompjuterit për modelim

- Të analizojë elementet dhe procedurat bazë për krijimin e modeleve me ane të programeve kompjuterike.
- Të përshkruajë mënyrën e ndërtimit të modeleve me anë të programeve të CAD/CAM.
- Të përshkruajë mënyrën e modelimit të figurave gjeometrike në veshje si funde, fustane, këmisha, xhaketa dhe pallto.
- Të përshkruajë mënyrën e ndërtimit të modelimit të fundeve, fustaneve me anë të programeve të ndryshme kompjuterike.
- Të përshkruajë mënyrën e ndërtimit të modelimit të pantallonave (F-M) me anë të programeve të ndryshme kompjuterike.
- Të përshkruajë mënyrën e ndërtimit të modelimit të xhaketave dhe palltove me anë të programeve të ndryshme kompjuterike.

Përfundimi i një modeli

- Të përshkruajë vendosjen e zburimeve dhe aksesorëve të veshjes përpara dhe pas qepjes (kopsat, dekorime, etj.);
- Të shpjegojë mënyrat e hekurosjes në varësi të llojit të veshjes, modelit dhe materialit tekstil të përdorur;
- Të shpjegojë etapat e paketimit të veshjes në varësi të llojit, modelit dhe materialit tekstil të përdorur.

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional “Modelim” niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK, individi do të zotërojë shprehinë profesionale, si më poshtë:

Organizimi i punës dhe komunikimi

- Të ndërtojë një plan të thjeshtë biznesi;
- Të zbatojë legjislacionin e punës në të gjithë elementët e tij;
- Të komunikojë në mënyrë profesionale me klientin, furnitorët dhe bashkëpunëtorët;
- Të shprehet saktë dhe në mënyrë profesionale;
- Të informojë në mënyrë profesionale klientët sipas kërkesave të tyre;
- Të kuptojë kërkesën e klientit dhe të marrë pjesë në ndërtimin e elementëve të një modeli të kërkuar;
- Të plotësojë kërkesat e porosisë së klientit brenda afatit të përcaktuar;
- Të krijojë marrëdhënieve korrekte me furnitorët dhe bashkëpunëtorët;
- Të zbatojë dokumentacionin/etiketat që shoqërojnë një veshje;
- Të plotësojë dokumentet e fletëhyrjeve dhe fletëdaljeve, të mallit dhe të porosisë;
- Të vendosë prioritetet në punën e përditshme;
- Të organizojë dhe zbatojë radhën e punës.
- Të punojë në ekip/grup duke zbatuar parimet e punës në ekip;
- Të llogarisë kostot të bazës materiale të punës dhe produktit përfundimtar;
- Të llogarisë kohën e punës për modele të ndryshme;

Sigurimi teknik

- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të materialeve të punës;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë zhvendosjeve në vendin e punës;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të makinave të ndryshme të qepjes;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të pajisjeve dhe mjeteve të punës;
- Të zbatojë rregullat e higjienës gjatë punës;
- Të zbatojë rregullat e ruajtjes së mjedisit;
- Të kryejë mbledhjen, klasifikimin dhe paketimin e mbetjeve dhe kryesisht atyre të rrezikshme;
- Të realizojë riciklimin e mbetjeve teknologjike.

Vizatimi i modeleve të veshjeve

- Të llogarisë proporcionet e trupit të njeriut;
- Të realizojë skicën teknike të detajeve të veshjes (jakat, xhepi, palat, vrimat, kopsat, zinxhiri, tegelat, etj.);
- Të realizojë skicën teknike të modeleve të ndryshme;
- Të vizatojë modelin e veshjes nga figurina në skicë teknike;
- Të paraqesë në vizatim ndikimin e materialit në veshje të ndryshme;
- Të zërthejë në vizatim pjesët përbërëse të një modeli;
- Të realizojë vizatimin skematik të veshjes si përpara ashtu edhe mbrapa.

Parapërgatitja për fillimin e punës

- Të marrë masat të duhura për elementë të ndryshëm të veshjes;

- Të përdorë mjetet e punës që nevojiten për ndërtimin e kallëpit të prerjes;
- Të zbatojë etapat e punës që nga skica teknike, zbërthimi dhe realizimi i kartëmodelit, vendosja mbi tekstil e deri te procesi i qepjes;
- Të përzgjedhë makinat qepëse të nevojshme për realizimin e kampionit të veshjes.
- Të përgatisë makinat qepëse të nevojshme për realizimin e kampionit të veshjes.

MODELIMI DHE PRERJA

Modelimi i fundeve

- Të realizojë spostimin e pencave në modelin e fundeve të ndryshme;
- Të realizojë modele të ndryshme të fundeve (fundi i drejtë, i ngushtë, me baskinë, me kinda, me pala, verëf etj.)
- Të realizojë kallëpin e prerjes së modeleve të ndryshme të fundeve;
- Të realizojë zbërthimin e skicës teknike në kallëpin e prerjes;
- Të realizojë lloje të ndryshme të xhepave që përdoren në funde të modeluara.
- Të bëjë përshtatjen e materialit të pëlhurës me modelin e fundit;
- Të përcaktojë marzhet e qepjes dhe cikateve në kartëmodelet e ndryshme të fundeve;
- Të vendosë në mënyrën e duhur kallëpin e letrës në tekstil;
- Të bëjë ndërhyrjen në kallëpin e prerjes për përmirësimin e defekteve të mundshme;

Modelimi i pantallonave (femra meshkuj)

- Të realizojë modele të ndryshme të pantallonave (femra dhe meshkuj);
- Të realizojë kallëpin e prerjes së modeleve të ndryshme të pantallonave;
- Të realizojë zbërthimin e skicës teknike në kallëpin e prerjes;
- Të realizojë lloje të ndryshme të xhepave që përdoren në pantallona të ndryshme, për femra dhe meshkuj;
- Të bëjë përshtatjen e materialit të pëlhurës me modelin e pantallonave;
- Të përcaktojë marzhet e qepjes dhe cikateve në kartëmodelet e ndryshme të pantallonave;
- Të vendosë në mënyrën e duhur kallëpin e letrës në tekstil;
- Të bëjë ndërhyrjen në kallëpin e prerjes për përmirësimin e defekteve të mundshme;

Modelimi i këmishëve (femra meshkuj)

- Të realizojë spostimin e pencave në modelin e këmishëve të ndryshme;
- Të realizojë modele të ndryshme të këmishëve (femra dhe meshkuj)
- Të realizojë kallëpin e prerjes së modeleve të ndryshme të këmishëve;
- Të realizojë zbërthimin e skicës teknike në kallëpin e prerjes;
- Të realizojë lloje të ndryshme të jakave, xhepave, mëngëve dhe manshetave që përdoren në këmisha të modeluara;
- Të bëjë përshtatjen e materialit të pëlhurës me modelin e këmishës;
- Të përcaktojë marzhet e qepjes dhe cikateve në kartëmodelet e ndryshme të këmishëve;
- Të vendosë në mënyrën e duhur kallëpin e letrës në tekstil;
- Të bëjë ndërhyrjen në kallëpin e prerjes për përmirësimin e defekteve të mundshme trupore;

Modelimi i fustaneve

- Të realizojë spostimin e pencave në modelin e fustaneve të ndryshme;
- Të realizojë modele të ndryshme të fustaneve (me penca, pa penca, dopio pet, lloje të ndryshme kindash, prerje poshtë gjoksit, për gra shtatzëna, sirena, asimetrike, me palëzime, fustan me mëngë të ndryshme etj.);
- Të realizojë kallëpin e prerjes së modeleve të ndryshme të fustaneve;
- Të realizojë zbërthimin e skicës teknike në kallëpin e prerjes;
- Të realizojë lloje të ndryshme të jakave dhe mëngëve që përdoren në fustane të modeluara;
- Të përshtatë materialin e pëlhurës me modelin e fustanit;
- Të përcaktojë marzhet e qepjes dhe ciklatjeve në kartëmodelet e ndryshme të fustaneve;
- Të vendosë në mënyrën e duhur kallëpin e letrës në tekstil;
- Të bëjë ndërhyrjen në kallëpin e prerjes për përmirësimin e defekteve të mundshme trupore;
- Të realizojë kallëpin e prerjes së modeleve të fustaneve për nuse dhe ceremoniale.

Modelimi i xhaketave dhe palltove (femra dhe meshkuj)

- Të realizojë spostimin e pencave në modelin e xhaketave dhe palltove të ndryshme për femra dhe meshkuj;
- Të realizojë modele të ndryshme të xhaketave dhe palltove (për femra dhe meshkuj);
- Të realizojë kallëpin e prerjes së modeleve të ndryshme të xhaketave dhe palltove;
- Të realizojë zbërthimin e skicës teknike në kallëpin e prerjes;
- Të realizojë lloje të ndryshme të jakave dhe xhepave që përdoren në xhaketa dhe pallto të modeluara;
- Të përshtatë materialin e pëlhurës me modelin e xhaketes dhe palltos;
- Të përcaktojë marzhet e qepjes dhe ciklatjeve në kartëmodelet e ndryshme të xhaketave dhe palltove;
- Të realizojë kallëpin e prerjes së modeleve të pardesyve dhe pelerinave për burra dhe femra;
- Të vendosë në mënyrën e duhur kallëpin e letrës tekstil;
- Të bëjë ndërhyrjen në kallëpin e prerjes për përmirësimin e defekteve të mundshme trupore;

Modelimi i veshjeve për fëmijë

- Të përzgjedhë materialin e përshtatshëm për veshje të ndryshme për fëmijë;
- Të realizojë prerjen e modeleve të veshjeve të ndryshme për fëmijë;
- Të realizojë kallëpin e prerjes së modeleve të veshjeve për fëmijë;

Të brendshmet

- Të përzgjedhë materialin e përshtatshëm për veshje të brendshme;
- Të realizojë kallëpin e prerjes së modeleve të ndryshme të kominosheve dhe tutave;
- Të realizojë kallëpin e prerjes së të linjtave (të brendshmeve) dhe rrobave të banjës;

Zhvillimi i numrave

- Të përcaktojë pikat e lëvizshme dhe të palëvizshme gjatë zhvillimit të numrave;
- Të realizojë grafikisht zhvillimin e numrave në skemën e prerjes;

Përfundimi i një modeli

- Të realizojë vendosjen e zburimeve dhe aksesorëve të veshjes përpara dhe pas qepjes

(kopsat, dekorime, etj.);

- Të përdorë mënyrat e hekurosjes në varësi të llojit të veshjes, modelit dhe materialit tekstil të përdorur;
- Të kryejë etapat e paketimit të veshjes në varësi të llojit, modelit dhe materialit tekstil të përdorur.

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.